

# Fletë informacioni

## për lehtësim

Lehtësimi zhvillohet në një mbledhje ekipi të tillë si një mbledhje e ekipi të programit edukativ të individualizuar (PEI), takim i planifikimit të vlerësimit ose një takim ekipi vlerësues. Lehtësuesi është një palë e tretë neutrale, që nuk është anëtar i grupit dhe nuk merr ndonjë vendim për grupin. Të paturit e një lehtësuesi ndihmon ekipin që të jetë produktiv dhe të mbajë përqendrimin te studenti. Lehtësuesit janë ndërmjetësues profesionistë, të cilët janë trajnuar nga Zyra për Fëmijët e Veçantë në proceset e edukimit të veçantë

## Cilat janë përfitimet e ndërmjetësimit?

### Prindërit dhe shkolla:

- Mbajnë fokusin mbi nxënësin;
- Janë në kontroll të rezultatit;
- Vazhdojnë për të shkruar një dokument në të cilin të gjithë mund të bien dakord;
- Kuptojnë më mirë këndvështrimin e tjetrit;
- Mund t'i zgjidhin çështjet më shpejt dhe
- Nuk duhet të paguajnë për të.

## Si të kërkojmë për një lehtësues?

### Prindërit dhe shkolla:

- Bien dakord për të kërkuar një lehtësues;
- Kontaktojnë Zyrën për Fëmijët e Veçantë. Nuk ka rëndësi se kush e kontakton zyrën;
- Mund të kontaktojnë seksionin e zyrës për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe të kërkojnë për ndërmjetësuesin/koordinatorin e lehtësimit në 877-644-6338;
- Marrin një shpjegim të procesit dhe marrin përgjigje për pyetjet nga ndërmjetësuesi/koordinatori i lehtësimit;
- Marrin një letër nga ndërmjetësuesi/koordinatori i lehtësimit duke shpjeguar sesi mund të zgjedhim një lehtësues dhe sesi mund të marrim informacion në lidhje me lehtësuesit të cilët janë në dispozicion;
- Dhe bien dakord me lehtësuesin dhe lejojnë Zyrën për Fëmijët e Veçantë që të dinë zgjedhjen e tyre. Zyra do të caktojë lehtësuesin e zgjedhur;

- Marrin ndihmë nga lehtësuesi në caktimin e takimit dhe
- Kontaktojnë zyrën për opsione të tjera, në qoftë se orari i takimit të grupit është vendosur tashmë.

## Çfarë ndodh në takim?

### Prindërit dhe shkolla:

- Fillojnë takimin e grupit ashtu sikundër ata zakonisht veprojnë. Lehtësuesi do të bëjë pyetje dhe do të ndihmojë grupin që të kthehet në rrugën e duhur, nëse takimi nuk është duke u përqendruar tek studenti ose nuk është duke ecur përpara në një mënyrë të dobishme;
- Mund të plotësojnë programin edukativ të individualizuar, formën e planifikimit ose raportin e vlerësimit të grupit në takim, të vendosin takime të tjera për të plotësuar procesin ose të kalojnë në ndonjë proces tjetër dhe
- U kërkohet që të vlerësojnë procesin e lehtësimit dhe lehtësuesin për të ndihmuar Zyrën për Fëmijët e Veçantë që ta bëjnë procesin më të mirë.

Informacioni i kontaktit i OD

